



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2018:027051

Datë: 08.05.2019

Numri i dokumentit: 00304835

P.nr.51/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN gjyqtari **Sulltan Dobraj**, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, ne çështjen penale kundër të pandehurit L.B., L. M. dhe E.V për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në bashkëveprim nga neni 327 par 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se sipas aktakuzës **PP/II.147/2018 të dt.29.03.2018**, kundër të pandehurit L.M. për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në bashkëveprim nga neni327 par.1. pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPK-ës, sipas aktakuzës PP/II.nr.303/2018 te dt.21.02.2018, kundër ët pandehurit L. B. për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1. nën par.1.1 të KPK-ës dhe dy veprave penale te vjedhjes së rëndë të mbetura ne tentativë sipas nenit 327 par.1. nën par.1.1 lidhur me nenin 28 të KPK-ës sipas aktakuzës PP/II.nr.28/2018 te dt.10.05.2018, në shqyrtimin gjyqësorë të mbajtur me dt.24.04.2019 me pjesëmarrjen e prokurorit të shtetit Ersan Qavolli, të pandehurit L.B. dhe mbrojtëses së tij Av. Merita Binakaj, të pandehurit L.M. dhe mbrojtëses së tij av. Venera Gashi, të pandehurit E.V. dhe mbrojtësit te tij av. Daut Cacaj, më dt.26.04.2019 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.**08.05.2019** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. I pandehuri L.B.**, i lindur me dt. ..., i biri i R., dhe i nënës F. e vajzërisë U., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, me numër personal: ..., shqiptar, shtetas i Kosovës, **gjendet në paraburgim nga dt. 30.03.2018.**
- 2. I pandehuri L. M.**, i lindur me dt. ... i biri i A. dhe nënës F. e vajzërisë A., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, me numër personal ..., me numër telefoni ..., shqiptar, shtetas i Kosovës.
- 3. I pandehuri E.V.**, i lindur me dt....,i biri i O. dhe nënës M. e vajzërisë S., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Kosovës.

J A N Ë F A J T O R

Të pandehurit L. B., L. M. dhe E. V.

Për shkak se :

1.Me dt.15,03,2017 rreth orës 01:30, në shkollën e mesme “V...” me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme dhe në bashkëveprim kanë marr sendin e huaj të luajtshëm pronë e drejtorit të shkollës B.V., në atë mënyrë që të pandehurit paraprakisht ishin marrur vesh duke i koordinuar rolet e tyre ashtu që më të arritur tek shkolla e lartcekur, me të kuptuar se aty nuk gjendet askush të njëjtit janë ofruar tek dritarja ku i pandehuri L. me mjet të përshtatshëm e duke përdorur forcën hap dritaren e zyrës së drejtorit, hynë brenda së bashku me të pandehurin E.V., demolojnë zyrën, aty vërejnë një lloptop të markës Lenova COREI 1, ngjyrë e zezë në vlerë prej 400 euro të cilën e marrin dhe e përvetësojnë ndërsa i pandehuri L. qëndron jashtë duke i ruajtur të pandehurit që mos po i vërente dikush e më pas të pandehurit largohen nga vendi i ngjarjes pa u vërejtur nga askush i cili laptop pas disa ditëve ishte konfiskuar nga ana e hestuesve policorë.

- **me çka në bashkëveprim kanë kryer vepër penale vjedhje e rendë nga neni 327 par 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK- së.**

I pandehuri L.B.

Për shkak se :

2. Me dt.03.10.2017 rreth orës 06:50 me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme ka përvetësuar sendet e lajshme pronë e të dëmtuarit SH.D. në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri ka shkuar te dyqani i pavarur tregtar “DPT X...” me çrast me forcë ka hapur derën e dyqanit dhe pasi që ka depërtuar brenda ka përvetësuar një sasi të cigareve të llojeve të ndryshme në vlerë prej 38 euro, si dhe para të imta në shumë prej 12 euro.

- **me çka ka kryer vepër penale “vjedhje e rendë” nga neni 327 par 1 nenpar.1.1 të KPRK- së.**

3. Me dt. 11.11.2017 rreth orës 08:30 me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme ka tentuar të përvetësoi sendet e luajtshme pronë e të dëmtuarit SH.K. në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri ka shkuar te shtëpia e të dëmtuarit me çrast me forcë ka thyer një dritare dhe pasi që ka depërtuar brenda shtëpisë ka kërkuar për gjëra me vlerë ashtu që pasi nuk ka gjetur është larguar nga vendi i ngjarjes pa u hetuar nga askush.

- **me çka ka kryer vepër penale “vjedhje e rendë” e mbetur në tentativ nga neni 327 par 1 nenpar.1.1 lidhur me nenin 28 të KPRK- së.**

4.Me dt. 11.11.2017 rreth orës 08:30 me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme ka tentuar të përvetësoi sendet e luajtshme pronë e të dëmtuarit SH.K. në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri ka shkuar te shtëpia e të dëmtuarit me çrast me forcë ka thyer një dritare të banjos në katin e parë të shtëpisë dhe pasi

që ka depërtuar brenda shtëpisë ka kërkuar gjëra me vlerë ashtu që pasi nuk ka gjetur është larguar nga vendi i ngjarjes pa u hetuar nga askush.

- **me çka ka kryer veprë penale “vjedhje e rendë” e mbetur ne tentativ nga neni 327 par 1 nenpar.1.1 lidhur me nenin 28 të KPRK- së.**

I pandehuri L. M.

Për shkak se:

5. Me datë 04.02.2016, rreth orës 06.20 në kafiterinë L... me dashje dhe në bashkëveprim si dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vetë, marrin pasurinë e luajtshme të dëmtuarit Z.K., në atë mënyrë që të pandehurit me të arritur në vendin e lartcekur fillimisht thyejnë derën e lokalit në fjalë dhe me pas i pandehurit L.B. depërton brenda lokalit dhe nga aty merr të hollat në shumë prej 280 euro, nga kuleta e cila ka qenë e vendosur ne banak të lokalit, ku shumën prej 100 euro më pas ja jep të pandehurit L.M., i cili ka qenë duke e pritur të njëjtin atë afër vendit të ngjarjes.

- **me çka ka kryer veprë penale “vjedhje e rendë” në bashkëveprim nga neni 327 par 1 nenpar.1.1 e lidhur me nenin 31 te KPRK- së.**

Andaj gjykata, ne bazë te nenit 7, 17, 28, 31, 41, 45, 46, 51, 58, 73, 74, 80 nenit 327 par 1 pika 1.1 te KPRK-ës, neneve 35, 359, 360, 361, 365, 366, 453, dhe 463 te KPPK-ës:

Të pandehurin L. B. e:

G J Y K O N ME DËNIM ME BURG DHE ME DËNIM ME GJOBE

Për veprën penale në piken **I.** të dispozitivit i përcakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe dënimin me gjobe ne shume prej 300 (treqind) euro.

Për veprën penale në piken **II.** të dispozitivit i përcakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe dënimin me gjobe ne shume prej 300 (treqind) euro.

Për veprën penale në piken **III.** të dispozitivit i përcakton dënimin me burgim në kohëzgjatje 1 (një) viti dhe dënimin me gjobë në shumë prej 150 (një qind e pesëdhjetë) euro.

Për veprën penale në piken **IV**. të dispozitivit i përcakton dënimin me burgim në kohëzgjatje 1 (një) viti dhe dënimin me gjobë në shumë prej 150 (një qind e pesëdhjetë) euro.

Gjykata në bazë të nenit 80 të KPK-ës

- I. I përcakton dhe i shqipton dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj dhe dënimin unik me gjobë në shume prej 900.00 (nëntëqind) euro.

Gjykata në bazë të nenit 82 te KPK-ës

- II. **Gjykata duke u bazuar në nenin 80 të KPK-ës**, shqipton dënim unik për te gjitha veprat penale (ne baze te neit 80 et KPK), dhe atë në aktgjykimet P.nr.49/2018 te dt. 01.04.2019 ku i pandehuri L. është gjykuar dhe dënuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (vite) vite e 6 (gjashtë) muaj dhe dënimin unik me gjobe në shume prej 3,000.00 (tremijë) euro për dy vepra penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 paragraf 1 nënparagraf 1.1 te KPK, si dhe në aktgjykimin P.nr.51/2018 të dt. 26.04.2019 është gjykuar dhe dënuar me dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj dhe dënimin unik me gjobë në shume prej 900.00 (nëntëqind) euro për dy vepra penale të vjedhjes se rëndë nga neni 327 paragraf 1 nën paragraf 1.1 te KPK dhe dy vepra penale të vjedhjes së rëndë të mbetura në tentativë nga neni 327 paragraf 1 nën paragraf 1.1 lidhur me nenin 28 të KPK,

Andaj i shqipton të pandehurit L. DËNIMIN UNIK me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 6 (gjashte) muaj dhe DËNIMIN UNIK me gjobë në shumë prej 3,900,00 (tremijë e nëntëqind) euro.

- III. Në bazë të nenit 83 te KPK, koha e kaluar në paraburgim nga dt.30.03.2018 të pandehurit L.B. i llogaritet DËNIMIN UNIK me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 6 (gjashte) muaj, duke filluar nga dita kur ky aktgjykim te merr formën e plotfuqishme.

Të pandehurin L.M. e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME KUSHT ME URDHËR PËR MBIKQYRJE NGA SHERBIMI SPROVUES

Për veprën penale në piken **I**. të dispozitivit i përcakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite i cili dënim nuk do te ekzekutohet në afat prej 2 (dy) viteve nëse i pandehuri L. nuk kryen ndonjë vepër tjetër

penale, dhe dënimin me gjobe në shume prej 500 (pesëqind) euro, të cilën gjobë i pandehuri duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për veprën penale në piken **V.** të dispozitivit i përcakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) viteve nëse i pandehuri L. nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, dhe dënimin me gjobë në shume prej 500 (pesëqind) euro, të cilën gjobë i pandehuri duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në bazë te nenit 80 te KPK-ës

Të pandehurit L. i përcakton dhe i shqipton dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, me kusht për 2 (dy) vite, dhe dënimin me gjobë në shumë prej 1.000,00 (një mijë) euro, te cilin gjobë i pandehuri duhet ta paguaj ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Të pandehurin E.V. e:

G J Y K O N ME DËNIM ME KUSHT ME URDHËR PËR MBIKQYRJE NGA SHERBIMI SPROVUES

Për veprën penale në piken **I.** të dispozitivit i përcakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) viteve nëse i pandehuri E. nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, dhe dënimin me gjobe në shumë prej 500 (pesëqind) euro, të cilën gjobë i pandehuri duhet ta paguaj ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Dënimi me kusht për të pandehurit L.M. dhe E.V. do të mbikëqyret nga shërbimi sprovues dhe urdhërohen të njëjtit që të mbajnë kontaktin me shërbimin sprovues dhe ju bëhet me dije në rast se shkëpusin kontaktet me shërbimin sprovues gjykata do të revokoi dënimin me kusht.

I dëmtuari B.V. drejtor i shkollës se mesme “V...” për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I dëmtuari SH.D. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

I dëmtuari SH.K. nga Deçani për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

I dëmtuari SH.K. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

I dëmtuari Z.K. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

I pandehuri L.B. obligohet qe ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 80 euro, i pandehuri L.M. obligohet qe ne emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 euro, dhe i pandehuri E.V. obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 25 euro, ndërsa secili nga të pandehurit veç e veç obligohen që në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën prej nga 30 euro, ndërsa për shpenzime të procedurës penale gjykata do të vendos me aktvendim të veçantë nëse gjen shpenzime të tilla.

A r s y e t i m

PTH ne Pejë ka kërkuar nga gjykata që të mbahet shqyrtimi gjyqësorë kundër të pandehurve L. B. L. M. dhe E. V. për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në bashkëveprim nga neni 327 par 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se sipas aktakuzës **PP/II.147/2018 të dt.29.03.2018**, kundër të pandehurit L.M. për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në bashkëveprim nga neni 327 par.1. pika 1.1

lidhur me nenin 31 të KPK-ës, sipas aktakuzës PP/II.nr.303/2018 te dt.21.02.2018, kundër të pandehurit L.B. për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1. nën par.1.1 të KPK-ës dhe dy veprave penale te vjedhjes së rëndë të mbetura ne tentativë sipas nenit 327 par.1. nën par.1.1 lidhur me nenin 28 të KPK-ës, sipas aktakuzës PP/II.nr.28/2018 te dt.10.05.2018, dhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë të administrohen provat e duhura e me në fund të njëjtit te shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit, si dhe te ngarkohen me shpenzimet e procedurës penale.

Gjykata themelore ne Pejë Dega ne Deçan me dt.24.04.2019 ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin gjyqësorë kundër të pandehurve L. B., L.M. dhe E.V., në të cilin shqyrtim të pandehurit e kanë pranuar fajësinë për të gjitha veprat penale me të cilat ishin të akuzuar sipas aktakuzave PP/II.147/2018 të dt.29.03.2018; PP/II.nr.303/2018 te dt.21.02.2018 dhe PP/II.nr.28/2018 te dt.10.05.2018, të cilin pranim fajësie gjykata e ka pranuar në bazë të nenit 326 lidhur me nenin 248 të KPPK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 35 te KPPK, ka marrë aktvendim ne procesverbal P.nr.51/2018 të dt.12.11.2018, me të cilin e ka bashkuar procedurën penale në qeshtjet penale P.nr.51/2018; P.nr.60/2018 dhe P.nr.78/2018, kundër të pandehurve, ku qeshtja penale e bashkuar është zhvilluar nën numrin P.nr. 51/2018.

Prokurori i shtetit ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse të pandehurit e pranuan fajësinë e këtë pranim fajësie mbështetet ne provat materiale

të cilat gjenden ne shkresat e lendes, në tersi mbetet pranë aktakuzave dhe cilësimit juridik të tyre, i ka propozuar gjykatës që të njëjtit të shpallen fajtor të dënohen sipas ligjit, lidhur me vendimin për dënim për të gjithë të pandehurit si rrethanë lehtësuese të merr pranimin e fajësisë, ndërsa për të pandehurin L. si rrethanë renduese të merr të kaluarën e tij kriminale.

Av. Merita Binakaj mbrojtëse e te pandehurit L. B. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i propozon gjykatës që për të pandehurin L. të merre rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë, moshën e tij të re ne kohen e kryerjes se veprës penale, pendimin e thellë të tij dhe premtimin që nuk do të kryej vepra penale.

I pandehuri L.B. ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se: shpreh keqardhje për veprat që i ka bërë, asnjë ditë nuk kalon që nuk ndihet i penduar për veprimet e tija, është penduar thellësisht, i vjen keq nga vetja që ka humbur kohën më të mirë duke shtuar se ka qenë dashtë që tani të ishte duke mësuar në shkollë e jo të vuaj për veprimet e tija, me e rëndësishme është sikur i pandehuri L. të ishte pranë familjes së tij që janë të vjetër dhe në moshë, dhe kanë nevojë për përkujdesje, e lut gjykatën që ti jep vetëm edhe një mundësi që të jenë pranë familjes (i pandehuri shprehet në te qajtur) duke shtuar se po i dhimbet shumë familja e tij që po vuajnë për fajin e tij, dhe të gjitha parat ja kanë kthyer të dëmtuarit Z. K..

Av.Venera Gashi mbrojtëse e te pandehurit L.M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se për të mos i përsëritur gjërat që i tha kolegja e saj av. Merita Binakaj, i ka propozuar gjykatës që me rastin konkret të matjes së shqiptimit të dënimit gjykata te ketë parasysh faktin se i pandehuri L. nuk ka qenë i dënuar më parë, pra është hera e parë që po gjykohet.

I pandehuri L.M. në fjalën përfundimtare deklaroi se :është i penduar për ato veprime, ka premtuar që në te ardhmen nuk do te kryej veprime të tilla, ka kërkuar falje dhe parat që ja ka dhonë L.i ja ka kthyer të dëmtuarit Z. në mëngjes.

Av. Daut Cacaj mbrojtës i te pandehurit E. V. në fjalën përfundimtare deklaroi se: i propozon gjykatës që në rastin e marrjes së vendimit mbi dënim të merr parasysh rrethanat lehtësuese se ka qenë hera e parë që i pandehuri E. ka kryer vepër penale, premtimin që në të ardhmen nuk do te kryej asnjë vepër penale dhe faktin se është penduar thellësisht.

I pandehuri E.V. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i vjen keq që ka kryer vepër penale, dhe ka premtuar se nuk do te kryej vepra të tilla.

Gjykata me pranimin e fajësisë ne tërësi e ka vërtetuar këto gjendje faktike:

Me dt.15,03,2017 rreth orës 01:30, në shkollën e mesme “V...” me qellim të përvetësimit në mënyrë te kundërligjshme dhe në bashkëveprim kanë marr sendin e huaj të luajtshëm pronë e drejtorit të shkollës B.V. në atë mënyrë që të pandehurit paraprakisht ishin marrur vesh duke i koordinuar rolet e tyre ashtu që më të arritur

tek shkolla e lartcekur, me të kuptuar se aty nuk gjendet askush të njëjtit janë ofruar tek dritarja ku i pandehuri L. me mjet të përshtatshëm e duke përdorur forcën hap dritaren e zyrës së drejtorit, hynë brenda së bashku me te pandehurin E.V., demolojnë zyrën, aty vërejnë një laptop të markës Lenova COREI 1, ngjyrë e zezë në vlerë prej 400 euro të cilën e marrin dhe e përvetësojnë ndërsa i pandehuri L. qëndron jashtë duke i ruajtur të pandehurit që mos po i vërente dikush e më pas të pandehurit largohen nga vendi i ngjarjes pa u vërejtur nga askush i cili laptop pas disa ditëve ishte konfiskuar nga ana e hestuesve policorë.

Me dt.03.10.2017 rreth orës 06:50 me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme ka përvetësuar sendet e lajshme pronë e të dëmtuarit SH.D. nga Deçani, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri ka shkuar te dyqani i pavarur tregtar “DPT X...” me çrast me forcë ka hapur derën e dyqanit dhe pasi që ka depërtuar brenda ka përvetësuar një sasi të cigareve të llojeve të ndryshme në vlerë prej 38 euro, si dhe para të imta në shumë prej 12 euro.

Me dt. 11.11.2017 rreth orës 08:30 me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme ka tentuar të përvetësoi sendet e luajtshme pronë e të dëmtuarit SH.K. në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri ka shkuar te shtëpia e të dëmtuarit me çrast me forcë ka thyer një dritare dhe pasi që ka depërtuar brenda shtëpisë ka kërkuar për gjëra me vlerë ashtu që pasi nuk ka gjetur është larguar nga vendi i ngjarjes pa u hetuar nga askush.

Me dt. 11.11.2017 rreth orës 08:30 me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme ka tentuar të përvetësoi sendet e luajtshme pronë e të dëmtuarit SH.K. nga Deçani në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri ka shkuar te shtëpia e të dëmtuarit me çrast me forcë ka thyer një dritare të banjos në katin e parë të shtëpisë dhe pasi që ka depërtuar brenda shtëpisë ka kërkuar gjëra me vlerë ashtu që pasi nuk ka gjetur është larguar nga vendi i ngjarjes pa u hetuar nga askush.

Me datë 04.02.2016, rreth orës 06.20 në kafiterinë L... K-Deqan, me dashje dhe në bashkëveprim si dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vetë, marrin pasurinë e luajtshme të dëmtuarit Z. K., në atë mënyrë që të pandehurit

me të arritur në vendin e lartcekur fillimisht thyejnë derën e lokalit në fjalë dhe me pas i pandehurit L.B. depërton brenda lokalit dhe nga aty merr të hollat në shumë prej 280 euro, nga kuleta e cila ka qenë e vendosur në banak të lokalit, ku shumën prej 100 euro më pas ja jep të pandehurit L.M., i cili ka qenë duke e pritur të njëjtin atë afër vendit të ngjarjes.

Gjykata paraprakisht te pandehurve ju ka sqaruar natyrën dhe pasojat e pranimiit të fajësisë dhe i ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë të njëjtit do të shpallen fajtor për veprat penale të lartcekura, do tu shqiptohet sanksioni i paraparë me ligj, dhe se nuk do të këtë procedure të provave.

Këto gjendje faktike gjykata i ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë që kanë bërë të pandehurit secili veç e veç për veprat penale për të cilat ishin akuzuar, ku të pandehurit secili veç e veç i kanë pasur të njohura natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe në mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo lajthim e kanë pranuar fajësinë për veprat penale më të cilat ishin të akuzuar, i cili pranim fajësie mbështetet në faktet e çështjeve që përmbajnë aktakuzat, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe se aktakuzat nuk përmbajnë asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Po ashtu gjykata duke u kujdesur zyrtarisht në bazë të nenit 257 të KPPRK-ës nuk ka gjetur ndonjë prove të pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë në bazë të nenit 248 të KPP-ës, ndërsa pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga secili i pandehur veç e veç, andaj kjo gjykate ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurve janë formuar të gjitha elementet e figurës së veprës penale të vjedhjes së rëndë në bashkëveprim nga neni 327 paragraf 1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK-ës, në veprimet e të pandehurit L. janë krijuar elementet e veprave penale vjedhje e rëndë në bashkëveprim nga neni 327 paragraf 1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK-ës, në veprimet e të pandehurit L. janë krijuar elementet e veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1. nën par.1.1 të KPK-ës dhe dy veprave penale të vjedhjes së rëndë të mbetura në tentativë sipas nenit 327 par.1. nën par.1.1 lidhur me nenin 28 të KPK-ës, gjykata ka konstatuar se të pandehurit janë përgjegjës për këto vepra penale, kanë qenë të vetëdijshëm për veprimet që i kanë ndërmarrë, i kanë dashur pasojat e shkaktuara me ato veprime, kanë qenë përgjegjës dhe të përgjegjshëm në kohën e kryerjes së veprave penale, andaj gjykata ka vendosur dhe të pandehurit i ka shpall fajtor për këto vepra penale, duke ju shqiptuar sanksionin penal secilit veç e veç si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në bazë të nenit 80 të KPPK të pandehurit L. B. i ka shqiptuar dënimin për secilën vepër veç e veç, pastaj i ka shqiptuar dënimin unik me burgim dhe dënimin unik me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke u bazuar në nenin 82 të KPK-ës të pandehurit L.B. i ka shqiptuar dënimin unik me burgim dhe dënim unik me gjobë për çështjet penale P.nr.51/2018 dhe P.nr.49/2019, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 83 të KPK, koha e kaluar në paraburgim nga dt.30.03.2018 të pandehurit L. B. i llogaritet DËNIMIN UNIK me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 6 (gjashtë) muaj, duke filluar nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e plotfuqishme.

Gjykata duke u bazuar në nenin 80 të KPK-ës të pandehurit L.M. i ka shqiptuar dënimin unik me (burgim dhe me gjobë) me kusht me urdhër për mbikqyrje nga shërbimi sprovues si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në bazë të nenit 41 të KPK-ës, ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurve dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, dhe në këtë mënyrë do të ndikoj në arritjen e qëllimit të

dënimit, të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të ndaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqërorë për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata në bazë të nenit 73 lidhur me nenin 74 të KPK-ës, me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat mund të ndikojnë në lartësinë dhe llojin e dënimit ndaj të pandehurve.

Rrethana lehtësuese për të pandehurin L. B. gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, pendimi i të pandehurit, premtimi i të pandehurit se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla.

Rrethana lehtësuese për të pandehurin L. M. gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, pendimi i të pandehurit, premtimi i të pandehurit se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe faktin se është hera parë që gjykohet për veprë penale.

Rrethana lehtësuese për të pandehurin E. V. gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, pendimi i të pandehurit, premtimi i të pandehurit se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe faktin se është hera e parë që gjykohet për veprë penale.

Gjykata duke u bazuar në nenin 58 të KPK-ës të pandehurve L. M. dhe E. V. ju ka shqiptuar dënimin me kusht me urdhër mbi mbikqyrje nga shërbimi sprovues sepse ka konsideruar se integrimi i të dënuarve në shoqëri do të bëhet më mirë duke u mbikqyrë nga shërbimi sprovues dhe i ka njoftuar të pandehurit L. dhe E. se nëse nuk mbajn kontaktet me shërbimin sprovues gjykata do të revokoi dënimin me kusht.

Gjykata në bazë të nenit 463 të KPPK-ës të dëmtuarit Z. K. SH. D. SH. K., SH.K. B. V. në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar i shkollës së mesme "V..." për realizimin e kërkesës pasurore juridike i ka udhëzuar në kontest civil.

Gjykata në bazë të nenit 453 të KPPK-ës, ka vendosur se i pandehuri L.B. obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 80 euro, i pandehuri L.M. obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 euro, dhe i pandehuri E.V. obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 euro, ndërsa secili nga të pandehurit veç e veç obligohen që në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën prej nga 30 euro, ndërsa për shpenzime të procedurës penale gjykata do të vendos me aktvendim të veçantë nëse gjen shpenzime të tilla.

Duke u bazuar ne te lartcekurat u vendos si ne dispozitiv.

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN,
P.nr.51/2018 te dt.08.05.2019**

Sekretarja juridike

Sabiha Hoxha

G J Y Q T A R I

Sulltan Dobraj

KËSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa nga palët në afat prej **15 ditësh** nga dita e marrjes së kopjes së këtij aktgjykimi, drejtuar **Gjykatës së Apelit në Prishtinë** përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2018:027051
Datë: 08.05.2019
Numri i dokumentit: 00304835